

LIGJ
Nr.7715, datë 2.6.1993

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7501, DATË 19.7.1991 "PËR
TOKEN"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 1 gërma "c" bëhen këto ndryshime:

Pas fjalëve "oborret e tyre", hiqet fjala "etj."

Pas fjalëve "historike e arkeologjike" hiqet fjala "etj." dhe shtohen fjalët "si dhe të gjitha tokat e tjera që nuk përfshihen në pikat "a" dhe "b" të këtij neni".

Neni 2

Në nenin 2, pas fjalëve "të drejtën e pronësisë", shtohen fjalët "mbi sipërfaqen e tokës".

Neni 3

Pas nenit 3 shtohet neni 3-a me këtë përmbajtje:

"Pronarët e tokës bujqësore mund t'ua japin atë me qira personave fizikë ose juridikë vendas a të huaj.

Për dhënien me qira të tokës bujqësore, zbatohen dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë kontratën e qirasë".

Neni 4

Në nenin 4 paragrafi i parë fjala "truall" zëvendësohet me fjalën "tokë" dhe pas fjalëve: "... për ndëtime...", shtohen fjalët: "dhe veprimtari të tjera ekonomike".

Neni 5

Neni 7 ndryshohet si vijon:

"Për dhënien e tokës në pronësi ose në përdorim personave juridikë a fizikë, si dhe për mënjanimin e çrregullimeve, krijohen: komisioni qeveritar i tokës pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, komisioni për ndarjen e tokës pranë këshillit të rrethit, komisioni i ndarjes së tokës pranë komunës dhe komisioni i ndarjes së tokës pranë fshatit.

Të drejtat dhe detyrat e komisioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

Neni 6

Në nenin 10 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kur në një fshat ka përfunduar ndarja e tapive të tokës dhe ndonjë person juridik a fizik nuk pranon të marrë tapinë, njoftohet zyrtarisht me shkrim brenda 15 ditëve nga përfundimi i ndarjes së tapive që të paraqitet për ta marrë atë. Në rast se edhe pas një muaji nga dita që ka marrë nftimin nuk e merr tapinë ose edhe ai që e ka marrë tapinë dhe deklaron me shkrim se e le tokë, e humbasin të drejtën e pronësisë ose të përdorimit mbi të. Në këto raste toka mbetet në dispozicion të shtetit.

Neni 7

Në nenin 19, pas fjalëve: "... ndërtime të ndryshme", shtohen fjalët: "dhe veprimtari të tjera ekonomike...".

Neni 8

Neni 21 ndryshohet si vijon:

"Organet e pushtetit lokal, brenda juridiksionit të tyre, ndalojnë çdo zënie dhe përdorim të tokës në kundërshtim me këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Në rastet e pushtimit, dëmtimit si dhe ndërtimeve të paligjshme nga persona fizikë a juridikë, kryeplaku, komisioni i ndarjes së tokës deri në funksionimin e tij, punonjësi i kadastrës, punonjësi i urbanistikës ligjore e punonjësi i policisë detyrohen të bëjnë denoncim për shkelje të këtij ligji.

Të drejtën e denoncimit për shkeljet e përmendura në këtë nen e kanë edhe pronarët dhe përdoruesit e tokës që e kanë marrë aktin e marrjes së tokës.

Denoncimi bëhet me procesverbal i cili dorëzohet brenda dy ditëve këshillit të komunës ose bashkisë të juridiksionit ku është bërë kundërvajtje.

Këshilli i komunës ose i bashkisë brenda 15 ditëve nga marrja e denoncimit detyrohet të mbledhet dhe të vendosë për:

a. lirimimin dhe kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme brenda 3 ditëve;

b. prishjen e objektit të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme në tokën e territorit të saj dhe kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme brenda 5 ditëve;

(Shpenzimet për kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme i ngarkohen kundërvajtësit.

Për pikën "a" dhe "b" veprohet kur kemi ndryshim të zërit kadastral si tokë bujqësore.);

c. dënimin me gjobë 5 lekë për metër katror;

ç. dëmshpërblimin për dëmin ekonomik që i ka shkaktuar personit fizik a juridik, të cilit i është dhënë toka në pronësi ose në përdorim.

Kur toka është e pandarë, dëmshpërblimi i jepet bashkisë ose komunës.

Për pikën "c" dhe "ç" veprohet kur kemi zaptim toke që përdoret për qëllime bujqësore.

Vendimi i këshillit të komunës ose bashkisë është i formës së prerë.

Organet e rendit publik të juridiksionit ku veprojnë, detyrohen që brenda 5 ditëve të zbatojnë vendimin e këshillit të komunës ose bashkisë.

Kur kundërvajtësi është banor i një rrethi tjetër, detyrohen organet e rendit publik të rrethit ku banon kundërvajtësi të zbatojnë vendimet e mësipërme.

Në rast se mbas masave administrative të parashikuara në këtë nen, kundërvajtësi nuk zbaton vendimin e marrë, këshilli i komunës ose i bashkisë e denoncon çështjen në organet e drejtësisë së rrethit.

Neni 9

Në nenin 23 të hiqen fjalët: "... që nuk e shfrytëzojnë vetë tokën e dhënë në pronësi ose përdorim, po ua japin të tretëve" dhe fjalët: "... që bëjnë ndërtime pa leje".

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.574, datë 26.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha